



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA ROSKOVEC

Adresa, Lagja nr.1 Roskovec, web:www.bashkiaroskovec.gov.al, nr.tel : 0387 80242

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE
PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

(Specialist)

**Lloji i diplomës “SHKENCA SOCIALE, DREJTESI, EKONOMI, PSIKOLOGJI”
Niveli minimal i diplomes: 'Diplome e Nivelit te Pare"**

Në zbatim të Nenit 22 dhe të Nenit 25, të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, VKM-së Nr.142 datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar ; si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave (I ndryshuar), **Bashkia Roskovec** shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve:

❖ **1(nje) Specialist per ndihmen ekonomike, Bashkia Roskovec**

Shpallja është e hapur për të gjithë nëpunësit civil të së njëjtes kategori në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil. Nëse nuk ka një fitues nga procedura e lëvizjes paralele, plotësimi i vendit vakant do të realizohet me procedurën e Pranimit në shërbimin Civil.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe Pranimin në Shërbimin Civil në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë.

- Afati për dorëzimin e dokumentave për

LEVIZJE PARALELE: 04.10.2019

- Afati për dorëzimin e dokumentave për

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL: 09.10.2019

Përshkrim i Përgjithshëm

Specialisti përgjigjet para Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimit Social për menaxhimin e çështjeve që lidhen me fushën e veprimtarisë së sektorit në përputhje me ligjet, aktet nënligjore apo aktet rregullatore në fuqi.

DETYRAT

Detyrat Kryesore

- Të identifikojnë familjet që kanë nevojë për ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuar dhe nevojat e individëve për shërbime të përkujdesit shoqëror;
- të verifikojnë gjendjen shoqërore e ekonomike të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike dy herë në vit dhe, për familjet që shpallen përfituese për herë të parë, verifikimi i parë të kryhet brenda tre muajve;
- të paraqesin pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki të dhënat për familjet/individët në nevojë, që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuar dhe personat që do të trajtohen me shërbime të përkujdesjes shoqërore;
- të ndihmojnë në përgatitjen e dokumentacionit për personat që aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike, pagesës së aftësisë së kufizuar dhe për shërbimet e përkujdesit shoqëror si edhe të administrojnë këtë dokumentacion;
- të hartojnë kërkesën për bllok-ndihmën dhe fondin e pagesës së personave me aftësi të kufizuar çdo dymujor për njësi të vetëqeverisjes vendore;
- të bashkëpunojnë për hartimin e planeve vendore dhe rajonale në mbështetje të personave në nevojë;
- të vlerësojnë nevojat e individëve ose familjeve që kërkojnë të marrin shërbime shoqërore, në përputhje me përparësitë kombëtare dhe vendore, mundësitë financiare për mbulimin e këtyre shërbimeve, të përgatisin dokumentacionin dhe propozimet për miratim në këshillin bashkiak;
- të grumbullojnë dhe të hartojnë informacione, statistika dhe të mbajnë regjistrin e përfituesve, të ndjekin shpenzimet për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe të personave që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror;
- të grumbullojnë informacione për rrjetet e shërbimeve publike dhe private që veprojnë në territorin e bashkisë ose njësisë administrative.
- të hedhin në regjistrin elektronik kombëtar të dhënat e deklaruara nga aplikuesit për ndihmë ekonomike;
- të kontribuojnë në procesin e hartimit të projektvendimit për propozimin që familja /individët në nevojë të trajtohen me ndihmë ekonomike si dhe të listës së personave me aftësi të kufizuar;
- të raportojnë pranë bashkisë të dhëna statistikore për numrin dhe fondin për familjet /individët përfitues të ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizua
- zbatojë detyrat që ka një punonjës për mbrojtjen e fëmijëve.
- Sigurimin e mbështetjes së punës së NJMF-së duke lehtësuar komunikimin edhe brenda strukturave të bashkisë.
- Alokimin e buxheteve të mjaftueshme në mënyrë që NJMF të funksionojë në mënyrë efikase duke përfshirë ofrimin e hapësirës dhe burimeve të përshtatshme në zyrë.
- Mundësimin e punonjësve të NJMF që të marrin pjesë në trajnime dhe aktivitete.

- Sigurimin që mbështetja e duhur teknike t'i ofrohet NJMF-së.
- Sigurimin e pjesëmarrjes së administratorëve socialë në takimet e mbrojtjes së fëmijëve dhe mbështetje për zhvillimin dhe zbatimin e planeve individuale të hartuara për fëmijën.
- Ofrimin e shërbimeve për fuqizimin e familjes.
- Ofrimin e shërbimeve alternative për fëmijët si: shërbimi i kujdestarisë etj.

I. Levizja Paralele

Kjo procedurë është e hapur vetëm për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

Kushtet minimale që duhet të plotësojnë kandidatët për lëvizjen paralele janë:

1. Të jetë nëpunëscivil i konfirmuar brenda të njëjtës kategori.
2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
3. Të ketë të paktën vlerësim e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”.

Kriteret e vecanta për këto pozicione janë:

- a) Te zoteroje diplome minimumi 3-vjecare, Diplomë “Bachelor”, në Degët ' , "Administrim Biznesi", Drejtesi, "Shkenca Sociale" . Nëse diploma është marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi
- b) te kete te pakten 1 vit punë.
- c) Te kete njohuri te një gjuhe te huaj;

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Njesise se Menaxhimit te Burimeve Njërëzore, të Bashkisë Roskovec, këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Një kopje të jetëshkrimit.
- Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit.
- Fotokopje e diplomës me listën e notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- Fotokopje e vlerësimit të fundit vjetor.
- Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
- Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Vërtetim gjëndjes gjyqësore dhe shëndetsore.

Dokumentat e mesiperme duhet te dorezohen deri me date **04.10.2019**

Rezultatet nga verifikimi paraprak të kushteve minimale të procedurës së lëvizjes paralele dhe të përmbushjes së kriterëve specifikë të vendit të punës do të dalin në datën **07.10.2019** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin në portalin

- Sherbimi Kombëtar i Punësimit
- Faqen zyrtare të Internetit të Bashkisë
- Stendën e informimit të publikut

Kandidatët që nuk kualifikohen do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njërëzore, për shkakët e moskualifikimit në të njëjtën ditë me shpalljen e listës së verifikimit paraprak të kandidatëve.

Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësine përgjegjëse të menaxhimit të Burimeve Njërëzore, brenda 3 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimeve.

Pas përfundimit të procedurës së sipërpermendur nepunësi me i lartë civil i institucionit brenda dy ditëve kalendarike urdheron ngritjen e komisionit të brendshëm.

Komisioni i brendshëm brenda 2 (dy) ditëve kalendarike nga data e krijimit të tij, zhvillon intervistën me gojë.

Intervista me gojë do të zhvillohet në ambientet e Bashkisë Roskovec më datë **17.10.2019 ora 11:00.**

Në intervistë kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në këto fusha:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr.139/2015 “Për vetqeverisjen Vendore”
- Ligji nr.9355 datë 10.03.2005 "Për ndihmen dhe shërbimet shoqërore.
- Konventa mbi të drejtat e fëmijëve.
- VKM nr.787 datë 14.12.2005 "Për përcaktimin e kriterëve të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike"
- Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik e tetraplegjik”, i ndryshuar
- Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;
- Si dhe akte nenligjore në zbatim të këtyre ligjeve.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatët do të vlerësohen nga **Komisioni i Brendshëm për Lëvizjen Paralele ngritur në Bashkinë Roskovec** nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a. **40 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë:
- b. 20 pikë për përvojën,
- c. 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse,
- d. 10 pikë për çertifikimin pozitiv.
- e. **60 pikë** për intervistën me gojë;

Komisioni, në përfundim të vlerësimit, rendit kandidatet sipas pikeve të grumbulluara dhe i dërgon listën njesise së burimeve njerezore të institucionit. Njesia e burimeve njerezore e institucionit, brenda 24 orëve nga dita që komisioni i njofton vendimin e tij, njofton individualisht kandidatet që kanë konkuruar për rezultatin e tyre. Kandidatet, pavarësisht nga drejta për të ankuar kanë të drejtë të bëjnë ankime me shkrim dhe në komisionin e brendshëm për lëvizjen paralele për rezultatin e vlerësimit, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual mbi rezultatin. Ankuesi merr përgjigje brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit.

Komisioni më **date 23.10.2019** njofton për vendimin e përzgjedhjes, Njesinë Përgjegjëse të Menaxhimit të Burimeve Njerezore.

Njesia Përgjegjëse e Menaxhimit të Burimeve Njerezore, me date **28.10.2019** shpall fituesin.

Njoftimi do të bëhet:

- në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”,
- në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec
- stenden e publikimeve të Bashkisë Roskovec.

II- Pranimi në Shërbimin Civil.

Nëse në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele nuk ka fitues, plotësimi i vendit vakant do të realizohet nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil në kategorinë e kzekutive.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar:

Kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.

- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar(hequr) sipas këtij ligji.

Kriteret e veçanta për këtë pozicion janë:

- a) te zoteroje diplome minimumi Bachelor (3 – vjecar) , në Degët: Drejtesi, Ekonomik, Psikologji. Diploma e nivelit “Bachelor” duhet te jete ne te njejten fushë. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- b) te kete deri në 1 vit punë.
- c) Te kete njohuri te një gjuhe te huaj;

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, **në Bashkinë Roskovec** , këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Një kopje të jetëshkrimit.
- Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje e diplomës.Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit.
- Fotokopje e diplomës me listën e notave.Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
- Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Vërtetim gjëndjes gjyqësore dhe shëndetësore.

Rezultatet nga verifikimi paraprak te kushteve minimale te procedures e pranimit në shërbimin civil dhe te permbushjes se kriterëve specifike te vendit te punes do te dalin ne daten **19.10.2019** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, ne portalin ”Sherbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e Internetit të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut.

Gjithashtu, po në këtë datë kandidatët që nuk janë kualifikuar do të njoftohen nga Njesia Pergjegjese e Menaxhimit te Burimeve Njerezore, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatet paraqiten ne Njesine Pergjegjese te Menaxhimit te Burimeve Njerezore brenda 5 diteve kalendarike nga dhe ankuesi merr pergjigje brenda 5 diteve kalendarike nga data e perfundimit e afatit te ankimit.

Konkurimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me goje, do te zhvillohet ne ambjentet e Bashkise Roskovec më datë **05.11.2019 ora 10:00.**

Në konkurimin me shkrim dhe intervistë e strukturuar me goje, kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në këto fusha:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr.139/2015 "Per vetqeverisjen Vendore"
- Ligji nr.9355 date 10.03.2005 "Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore.
- Konventa mbi te drejtat e femijeve.
- VKM nr.787 date 14.12.2005 "Per percaktimin e kritereve te procedurave dhe te mases se ndihmes ekonomike"
- Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik e tetraplegjik", i ndryshuar
- Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike;
- Si dhe akte nenligjore ne zbatim te ketyre ligjeve.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen nga Komisioni i Përhershëm i Pranimit, i ngritur pranë Bashkisë Roskovec.

Totali i pikeve te vleresimit te kandidateve eshte 100 pike te cilat ndahen perkatesisht:

- a. 15 pike për dokumentacionin e dorëzuar;
- b. 25 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. 60 pikë për vlerësimin me shkrim.

Komiteti i Përhershëm i Pranimit, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin "*Specialistit I Nihmave Ekonomike*".

Në rast se dalin fitues më shumë se një kandidat, me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikës 13, të kreut IV, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë, 18.03.2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive".

Komiteti i Përhershëm i Pranimit brenda 24 (njëzet e katër) orëve, pra më **date 06.11.2019** ve ne dispozicion listen e fituesve, Njesise se Menaxhimit te Burimeve Njerezore.

Njesia e Menaxhimit te Burimeve Njerezore, me **date 19.11.2019** shpall listen e fituesve.

Njoftimi do të bëhet:

- në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit
- në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec
- ne stenden e informimit publik te Bashkise Roskovec.

Per sqarime te metejshme mund te kontaktoni ne :

e-mail : oltaristani@yahoo.com

nr.tel: **0387 80242.**

NJESIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJEREZORE

BASHKIA ROSKOVEC